

Brunilda Zenelaga është diplomuar në Fakultetin e Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës në



degën Sociologji. Ajo mbaroi studimet master dhe ato të doktoraturës në të njëjtën fushë. Brunilda ka marrë pjesë në kualifikime universitare dhe pasuniversitare në universitetin Montpellier në Francë dhe atë të Siena-s në Itali. Tani ajo punon si lektore me kohë të plotë në Departamentin e Sociologjisë, Fakulteti Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës.

Brunilda ka një përvojë rreth 20 vjeçare në fushën e zgjidhjes së konflikteve. Ajo është promovuese e zgjidhjes së konflikteve me ndërmjetësim, duke bashkëpunuar me Fondacionin Shqiptar të Zgjidhjes së Konflikteve dhe Pajtimit të Mosmarrëveshjeve (FZKPM) në Tiranë. Brunilda është gjithashtu një praktikuese,

kërkuese dhe hartuese manualesh në lidhje me Ndërmjetësimin dhe Drejtësinë Restauruese si dhe autore dhe bashkëautore e mjaft artikujve shkencorë. Ajo ka mbajtur disa kumtesa në konferenca shkencore brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, mjaft prej të cilave me fokus menaxhimin dhe zgjidhjen e konflikteve, ndërmjetësimin dhe drejtësinë restauruese.